



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivry	07. 06 2021	1	viti god year.
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHICK	2916/2021		1/3.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr. 417/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.417/2021 të datës 14.05.2021, të parashtruar nga ankuesi grup ankuesish Zejdush Rexhepi dhe të cilët me autorizim i përfaqëson Avokat Labinot Buzuku, kundër mosveprimit të Komunës së Gjilanit, në çështjen juridike-administrative "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të oovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 07.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr. 417/2021 të datës 14.05.2021, të parashtruar nga grup ankuesish Zejdush Rexhepi dhe

A r s y e t i m

Ankuesit dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar më datë 14.05.2021 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 2931/2021, të regjistruar me A.nr. 417/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mosveprimit të Komunës së Gjilanit lidhur me pagesën e pagave jubilarë si dhe shujtës ditore sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.05.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Komuna e Gjilanit, ndërsa kjo e fundit me datë 24.05.2021, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, për vendosje në mënyrë meritore ka administruar këto prova: Ankesën A.Nr. 417/2021 të datës 14.05.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 13.11.2019, për autorizimin e _____ nga
Autorizimin e datës 13.11.2019, për autorizimin e Av. _____ nga
Përgjigjen në kërkesë të datës 05.05.2021 të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Gjilanit; kërkesën e datës 19.04.2021, drejtuar Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Gjilanit; Vërtetimin e datës 29.11.2019 për _____ Vërtetimin e datës 08.03.2021 për _____ Akt Emërimit e datës 20.10.2021 për _____ Vërtetimin e datës 27.11.2019 për _____ Vërtetimin e datës 08.03.2021 për _____ Kontratën e punës së datës 13.10.2014 për _____ Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë; Aktgjykimin C.Nr.1090 të datës 01.07.2020 të Gjykatës Themelore në Gjilan/ Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil; Aktgjykimin AC. Nr.5452/2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Kontratën e punës të datës 13.10.2014 për _____ Akt Emërimit e datës 01.09.2011 për _____ Përgjigjen në ankesë të datës 26.05.2021, me numër protokollit 2637/2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve _____ dhe _____ sepse:

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi _____ mbanë pozitën e punës së Zëvendës Drejtorit të Shkollës së Mesme Ekonomike "Marin Barleti" në Gjilan, ndërsa _____ nbanë pozitën e punës së Sektorit të kësaj shkolle. Të njëjtit me datës 22.04.2021 i janë drejtuar me kërkesë më shkrim Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Gjilanit për kompensimin e shujtës ditore dhe shpërblimit jubilar për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri 31.03.2021. Drejtoria e Arsimit të Komunës së Gjilanit, përmes shkresës së datës 05.05.2021 ka njoftuar ankuesit se kompensimi i shujtës ditore dhe shpërblimit jubilar nuk mund të realizohet për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore. Ankuesit pas këtij njoftimi, me datë 14.05.2021 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimor që bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës, ju njihet e drejta e kompensimit të shujtës ditore dhe shpërblimit jubilar. Me tutje, kanë kërkuar që Këshilli të aprovoj ankesën dhe të detyroj Komunën e Gjilanit që ankueseve ti kompensoj shpërblimin jubilar dhe kompensimin e ushqimit për periudhën nga data 18.04.2017 deri me datë 31.03.2021 sipas përvojës së punës dhe ditëve të punës .

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave duke ju referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se 3. **Nëpunës civil** - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë: 4. **Nëpunës i Shërbimit Publik** - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, ka konstatuar se zyrtaret publik të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Publike të



Arsimit Para universitar në Kosovë, kanë statusin e nëpunësit të Shërbimit Publik respektivisht në këtë kuptim ankuesit nuk e kanë statusin e nëpunësit civil.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesit kanë statusin e nëpunësit të Shërbimit Publik, Kolegji për shqyrtimin e ankesës vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.417/2021 të datës 14.05.2021, të parashtruar nga grup ankuesish dhe

Pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, Kolegji udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 4 ku përcaktohet se: *Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.*

Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda Nr. A. Nr. 417/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita Haxhmikaj - Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Të autorizuarit të ankuesve Av.
- Kryetarit të Komunës së Gjilanit;
- Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Gjilanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së